



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 70/2018

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2017

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2017, sipas dokumenteve të mëposhtme, pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

- a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2017;
- b) raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2017, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2017;
- ç) raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, për vitin 2017;
- d) raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2017.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 18.10.2018